



Fjalët kanë ndikim të madh në shpirtra të njerëzve. Një fjalë e mirë mund të jetë këshillë aq e madhe saqë të jetë shkak edhe për pendimin e ndonjë mëkatari të madh. Ato zakonisht janë të shkurtra por në vete ngërthejnë mësim me rëndësi saqë as edhe libra shumë vëllimshme nuk mund t'i përmbajnë. Kjo ngase ato thuhet në atë formë që vlejnë për kohë dhe gjenerata të ndryshme. Edhe sot e kësaj dite, ne citojmë thënie nga njerëz të mençur të kohëve të lashta.

Por, ato jo çdokush mund t'i thotë...Një prej atyre që Allahu i Madhëruar e nderoi me këtë thesar urtësie ishte edhe i Dërguari, Muhammedi, alejhi's selam. Jo rrallë këshillonte njerëzit me një fjalë (fjali) që vërtetë ishin ajka e zgjidhjes së problemit. Nëse iu janë bërë zemrat të vrazhda dhe ndieni se jeni larguar prej Allahut të Madhëruar, atëherë:

“?????? ?? ??? ??????”

Shpeshtojeni përkujtimin e shkatërruesit të kënaqësive (vdekjen)”[\[1\]](#)

Nëse do të shpëtosh nga problemet përreth, nga sprovat, atëherë:

“???????? ????????? ????????? ????????? ??????????”

“...qëndro në shtëpinë tënde dhe kape gjuhën (mos fol)”[\[2\]](#)

...e shumë e shumë thënie tjera të shkurtra por me urtësi të mëdha. Zaten, Muhammedi, alejhi's selam, pati deklaruar se:

“???? ????????? ??????”

Jam dërguar me Xhevamiu'l kelim (elokuencë të rrallë)”[\[3\]](#)

Porosia, detaje të së cilës do të mundohemi të sjellim në këtë shkrim, është e regjistruar në Sunenin e Ibni Maxhes ndërsa është transmetuar nga Sahabiu i madh, Ebu Ejub el-Enariu. Sahabiu në fjalë rrëfen se një njeri kishte ardhur tek Pejgamberi, alejhi's selam dhe i kishte thënë:

“??? ?????? ??????? ?????????? ?????????? ?????? ?????? ?????? ??? ??????????
????????? ?????????????????? ?????????????????? ?????????????????????? ?????? ??????????
????????????? ?????? ??? ?????????? ??????????”

O i Dërguari i Allahut! Më mëso, por shkurt! (Pejgamberi, alejhi's selam i) tha: Kur të ngritësh për namaz, falu sikur fal namaz lamtumirës (je për herë të fundit), mos fol fjalë që më vonë do të pendohesh për to dhe vendos për të mos shpresuar në atë që posedojnë njerëzit (mos u bë i varur prej tyre).”[\[4\]](#)

Ky hadith, siç mund të vërehet, jep konstruksionet për një jetë të lumtur, një jetë të mirë, në radhë të parë me Krijuesin, e pastaj edhe me krijesat – njerëzit. Hadithi përshkruan rrugën, e cila njeriut i dhuron atë epitelin prej besimtari të vërtetë. Të falësh namaz me përkushtim, të kultivosh raporte të mira me Krijuesin, në njërën anë, dhe të krijosh raporte të matura me njerëzit, duke mos i shqetësuar me gjuhën tënde por as duke mos u bërë i varur nga paratë e tyre, në anën tjetër, është esenca dhe thelbi i një krenarie, të cilën vetëm besimtari i sinqertë mund ta disponojë.

Porosia e pare: NAMAZI I PËRKRYER

Namazi është shtyllë e besimit, është lidhja e robit me Zotin e tij, është ajo në të cilën besimtari gjen prehje shpirtërore. Për të arritur efektin e vet, namazi duhet të kryhet në përputhje me parimet, dhe jo vetëm me parimet, pro krahas kësaj motiv për të duhet të jetë dashuria e madhe që kemi për Allahun e Madhëruar. Nga këtu, Muhammedi, alejhi's selam, na porositi që kur ta bëjmë namazin ta bëjmë sikur nuk do të falemi më, sikur falemi për herë të fundit.

E perse duhet të falemi me kaq përkushtim do të mundohem ta jap përgjigjen nëpërmjet shembullit në vijim. Nëse ftohesh për të dalë para një sundimtari shumë të fuqishëm, para një njeriu që ka në dorë udhëheqjen e botës, ti këtë e konsideron si nder dhe mburrje. Nëse të thuhet se ky mund të jetë takimi yt i fundit me atë njeri, atëherë ti mundohesh që ta shfrytëzosh këtë shans maksimalisht duke u përkujdesur edhe për detajet dhe imtësitë, për shprehjet dhe lëvizjet, qofshin këto edhe më të thjeshtat. E, nëse pas kësaj të jepet rasti të takohesh prapë me atë njeri, kjo jo që nuk ta humb seriozitetin që ke, përkundrazi, të bën edhe më kureshtar madje për të përmirësuar ndoshta atë për të cilën e ke qortuar veten nga takimi i kaluar. E tash, nëse bën një krahasim ndërmjet Allahut të Madhëruar, si Krijues dhe Sundues suprem dhe këtij njeriu që sundimi i tij është i përkohshëm dhe se me gjithë fuqinë që ka, prapë në raport me Allahun e Madhëruar nuk është asgjë, atëherë ajo më e pakta që ne duam prej teje të jesh/bësh në raport me Allahun e Madhëruar është që të tregosh kësi respekti. Duam të kuptosh se ti në namaz je në kontakt – bashkëbisedim me Allahun e Madhëruar. Ebu Hurejre transmeton se Pejgamberi, alejhi's selam ka cituar Allahun e Madhëruar të ketë thënë:

“????????? ?????????????????? ?????????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ??? ??????
????????? ?????? ?????????????? ?????????????? ?????????? ?????? ?????????????????? ?????? ??????????”

Çështja e të folurit është një prej gjërave që Islami e ka diskutuar shumë hollësisht. Kjo për shkak se ai mund të jetë çelës shpëtimi (p.sh. deklarimi i shehadetit) por mund të jetë edhe shkatërrim. E besimtari që shquhet përgjithësisht për përmbajtje dhe maturi, ftohet që

personalitetin e vet ta kompletojë duke përmbushur edhe këtë kriter, pra të folurit me përgjegjësi. Ndryshe, të folurit jo vetëm që llogaritet, siç na mëson Allahu i Madhëruar në kaptinën Kaf, ajeti 18, por ai, nga pakujdesia mund të jetë fatal për njeriun, në kuptimin e humbjes së Xhenetit. Pejgamberi, alejhi's selam ka thënë:

“???????? ?????????? ?????????????? ?????????????? ???? ?????? ????????? ??????????
????? ?????????????? ?????? ??? ??????????”

...dhe robi ndodhë të flet ndonjë fjalë nga hidhërimi i Allahut, e që nuk i kushton rëndësi të madhe, e si shkak të bjerë thellë në Xhehennem...”^[9]

Të folurit është i rrezikshme për faktin se kur thuhet më nuk kthehet, është sikur shigjeta, kur del prej harkut nuk dihet se ku qëllon, por kudo që të jetë prapë dëmton. Një njeri i mençur kishte thënë: *Nuk jam penduar për atë që nuk e kam thënë, por jam penduar për atë që shumë herë e kam thënë.* Një tjetër kishte thënë: *Çdo fjalë që nuk e kam thënë, jam ende pronar i saj ndërsa çdo fjalë që e kam thënë, jam bërë pronë e saj.* ^[10]

Porosia e trete: MOS U BË I VARUR NGA NJERËZIT!

Paraja është disi e mishëruar me njeriun. Allahu ka thënë:

“???????????????? ?????????? ??????? ???????

Dhe pasurinë e doni së tepërmi.” el-Fexhr, 20.

Kështu, të kërkosh nga njerëzit, rrallë se mund të shpëtosh pa ndonjë ofendim, në rastin më të lehtë, apo kushtëzim në rastin më të keq. “Unë të jap por ti duhet të bësh kështu e kështu për mua.”

Pejgamberi, alejhi's selam është porositur nga Xhibrili se:

“????? ?????????? ?? ??????

Krenaria e tij (besimtarit) është në pavarësimin e tij nga njerëzit!” 25.

Më konkretisht, Muhammedi, alejhi's selam, është munduar që besimtarit të devotshëm t'i përshkruajë rrugën drejt shpëtimit në këtë dhe botën tjetër. Nëse do që të mos jesh viktimë e shpirtëkëqinjëve por që edhe tek njerëzit dhe tek Zoti të jesh i dashur, atëherë ke vetëm një mundësi. Pejgamberi, alejhi's selam thotë:

“????????? ??? ?????????????? ?????????? ?????????? ?????????? ??????? ??? ?????????? ??????????
?????????????”

Bëhu asket në dunja, të do Allahu, bëhu asket nga ato që posedojnë njerëzit, të duan njerëzit!”^[11]

Kjo, krahas asaj që nëse ti lyp sikur po e nënshtron veten para njerëzve, është edhe keqkuptim i pasurisë, ngase pasuri nuk është të kesh shumë para por pasuri është zemra, besimi, pajtimi me atë që të ka dhënë Allahu^[12]. Edhe Pejgamberi, alejhi's selam ishte i varfër por na tregoi se njeriu nuk vlerësohet nga xhepi por nga zemra. Besimtarët e parë ishin të varfër por nuk e shfaqnin dot varfërinë, ata vetëm për Allahun e Madhëruar kishin nevojë. Nga këtu, njerëzit, siç thotë Allahu i Madhëruar, kur i shihnin krijonin përshtypjen se ata janë të pasur.

“????????????? ?????????? ?????????? ???? ??????????????”

... ai që nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur...” el-Bekare, 273.

Kështu duhet të jetë besimtari. Një përshkrim i shkurtër por shumë domethënës. E lus Zotin që të na bëjë prej besimtarëve, me të cilët Ai është i kënaqur!

Përgatiti: Sedat ISLAMI

^[1] Buhariu.

^[2] Transmeton Ebu Davudi ndërsa Albani në Silsiletu's sahihah e ka cilësuar hasenun sahih.

^[3] Buhariu (teksti i tij) dhe Muslimi.

^[4] Albani këtë hadith e konsideron hasen.

[5] Muslimi.

[6] Ihjau Ulumiddin, 1/151.

[7] Ibid.

[8] Transmeton Tirmidhiu ndërsa Albani e ka cilësuar autentik.

[9] Buhariu.

[10] http://www.geocities.ws/sedat_islami/hifdhulisan.html

[11] Transmeton Ibni Maxheh ndërsa Albani e ka cilësuar autentik.

[12] Pejgamberi, alejhi's selam ka thënë: "?????? ?????????? ???? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? ?????????? Pasuria nuk është në mall të shumtë por (pasuria është) në pasuri të shpirtit" (Buhariu); "????????? ?????? ?????????? ?????????? ?????? ?????????? ?????????? ?????????? ...dhe pajto me atë që të ka dhënë Allahu do të jesh njeriu më i pasur..." (Transmeton

Tirmidhiu ndërsa Albani e ka cilësuar hasen).